



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L– 40, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/04, qershor 2008), të dispozitave të nenit 5, paragrafi 5.2 dhe nenit 8, paragrafi 8.2 të Ligjit nr. 03/L-087, për ndërmarrjet publike, të nenit 34, paragrafi 34.1, shkronja d të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 13.9.2024, miratoi këtë

VENDIM
PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT TË AKSIONARËVE TË
NDËRMARRJES PUBLIKE TË KOMUNËS SË PRISHTINËS

I

MIRATOHET Vendimi për emërimin e anëtarëve të Komisionit të aksionarëve të ndërmarrjes publike lokale të Komunës së Prishtinës “Trafiku Urban”, SHA.

II

Anëtarë të komisionit të cekur në pikën I të këtij vendimi janë:

1. Muhamet Gubetini, anëtar,
2. Triumf Sadikaj, anëtar.

III

Aksionarët e emëruar kanë të drejtë të veprojnë në emër të Komunës dhe duhet të veprojnë në përputhje me Ligjin e ndërmarrjeve publike dhe Ligjin për shoqëritë tregtare.

IV

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-020/04-121999/24,më16.09.2024

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

